

**Albulena ALIDEMA**  
**NDIKIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE PËR NXËNIEN E GJUHËS**  
**STANDARDE SHQIPE**

Vitet e para të fëmijërisë janë përcaktuese për zhvillimin e shkrim-leximit të njeriut, prandaj zhvillimi i gjuhës dhe shkrim-leximit është një proces që fillon me lindjen dhe zgjat tërë jetën. Mësimnxënja nuk fillon në shkollë. Të mësuarit fillon në shtëpi me përdorimin e gjuhës amtare. Prandaj, fillimi i ndjekjes së mësimin në shkollë për fëmijët është vazhdim i mësimnxënies së filluar në shtëpi dhe përdorim i gjuhës që ata e kanë folur në shtëpi, me përjashtim në rastet kur gjuha në shkollë është e ndryshme prej asaj amtare, që ka fëmija, pra është gjuhë e dytë. Megjithatë, për shkollarët e klasës së parë, (6-7 vjeç) fillimi i ndjekjes së shkollës, i gjen ata në një ambient të ri fizik dhe social. Për ta, gjithçka rreth tyre është e re: ambienti, mësuesi (*si autoritet qendror*), e deri te tekstet mësimore që janë në dispozicion të nevojshëm për zhvillimin e mësimin. Në këso rrethanash, kontaktet e para të fëmijëve me tekstet shkollore i shtynë ata të largohen nga varianti i gjuhës, me të cilën janë mësuar prej kohësh dhe t'i qasen një standardi gjuhësor, me të cilin janë shkruar tekstet mësimore dhe, si të tilla, janë obliguese për plan-programin shkollor.

Por, shkollat nuk janë vendet ku për herë të parë fëmijët përballen me një standard gjuhësor. Janë kopshtet dhe çerdhet (*për grup-moshat deri në 6 vjeç*) ku fëmijët bëhen pjesë e një sistemi (*joformal*) që mundëson ushtrimin dhe përvetësimin e të folurit në gjuhën standarde. Meqë në kopshte nuk kemi një kurrikulë zyrtare për mësimin e gjuhës standarde, përballja e parë e fëmijëve për mësimin e gjuhës standarde nis në klasën e parë.

Në këtë punim kemi trajtuar aspekte dhe problematika të procesit të nxënies së gjuhës standarde shqipe përmes teksteve shkollore kryesisht të ciklit të ulët fillor. Janë identifikuar disa nga rastet problematike në përmbajtjet e këtyre teksteve, që në vlerësimin tonë, paraqesin vështirësi në rrugën e nxënies dhe përvetësimit të standardit gjuhësor nga ana e nxënësve.

**Tekstet mësimore si burim kryesor i nxënies së standardit gjuhësor**

Siç ndodh në shumicën e vendeve, edhe në Kosovë, procesi për përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore është përgjegjësi institucionale dhe mbështetet në një program dhe politikë të miratuar dhe zbatuar nga Ministria e Arsimit, prandaj, pavarësisht autorëve dhe shtëpive botuese, tematikat e trajtuara në përmbajtje të librave ndjekin të njëjtën linjë dhe i nënshtrohen respektimin të standardit të gjuhës shqipe.

Tekstet e reja të gjuhës shqipe, që përdoren aktualisht, me theks të veçantë në nivelin e parë të shkollimit, nuk janë më të ndara në gjuhë (*që deri më tani ka nënkuptuar gramatikën*) dhe në lexim letrar (*që ka nënkuptuar letërsinë*), ashtu siç ishin vite më parë, por të dy këto tekste funksionojnë

si të integruara dhe janë konceptuar e përpiluar për të qenë në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit të nxënësve përmes shkrimit dhe leximit në gjuhën standarde shqipe.

Për përvetësimin e gjuhës ekzistojnë burime të ndryshme, që nuk kufizohen vetëm në tekste shkollore ose libra të tjerë. Edhe mediumet audiovizive, si dhe qasja e pakufizuar në internet, e kanë rolin dhe rëndësinë e tyre në nxënien, ose jo, të gjuhës standarde, veçanërisht te fëmijët. Por, pavarësisht kësaj shumëllojshmërie burimesh, tekstet shkollore në Kosovë ende konsiderohen si burimi kryesor i informacionit dhe pothuajse i vetmi për realizimin e mësimin të gjuhës standarde në shkollë. Në këtë kontekst, për suksesin apo mosp suksesin e arritjes së objektivave të përcaktuara në programet mësimore, për nxënien e gjuhës standarde, rolin kryesor në shkollë e kanë tekstet dhe vetëm tekstet mësimore.

Është fakt i pamohuar se gjuha e librave mësimorë ka rol dhe rëndësi vendimtare si për rritjen cilësore të mësimdhënësit, ashtu edhe për formimin gjuhësor të nxënësve, me qëllim që ata të përvetësojnë sa më mirë gjuhën letrare kombëtare, të bëhen të ndërgjegjshëm për vlerat dhe dobinë e saj dhe ta përdorin atë si mjet zhvillimi e përparimi në jetën e përditshme dhe të ardhmen e tyre prosperuese. Angazhimi për të mundësuar një mënyrë dhe qasje më të lehtë në përvetësimin e gjuhës standarde shqipe ka qenë i vazhdueshëm dhe nuk ka ndaluar përgjatë dekadash. Kështu, duhet risjellë në kujtesë se *pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) është bërë një punë e gjerë dhe e larmishme për përmirësimin gjuhësor të programeve dhe të librave mësimorë. Janë bërë përpjekjet për t'i ndërtuar ato mbi baza të shëndosha shkencore, duke pasqyruar gjithnjë e më mirë arritjet e shkencës gjuhësore shqiptare*<sup>1</sup>.

Në rrjedhë të këtyre zhvillimeve është kultivuar dhe trashëguar një traditë e mirë në hartimin e teksteve shkollore për të gjitha disiplinat, sidomos në fushën e gjuhës, ku bien në sy numër shumë i madh i abetareve dhe i gramatikave, të cilat kanë qenë dhe janë në dispozicion të nxënësve filloristë. Kur jemi te procesi i përpilimit dhe botimit të teksteve mësimore duhet thënë se këtu rëndësi të madhe ka edhe zbatimi i plotë i rregullave të normës së gjuhës standarde në tekstet mësimore. Duhet të theksohet, se për një kohë relativisht të gjatë, *pas Kongresit të Drejtshkrimit, një numër i konsiderueshëm tekstesh mësimore për shkollat fillore dhe të mesme, për shumicën e lëndëve, kanë qenë të përkthyer nga gjuhët sllave pa një frymë origjinale të strukturës së gjuhës shqipe. Në këto tekste vëreheshin shkelje të shpeshta të normës*<sup>2</sup>. Ndërsa, me kalimin e kohës, përgjatë viteve '90 vërehej një përparim i dukshëm në hartimin e teksteve unike shkollore për mësimin e gjuhës standarde shqipe. Ky zhvillim përparues ndikoi, sadopak, në procesin e përvetësimit të normës standarde nga ana e nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme, edhe pse jo në nivelin e dëshiruar dhe të pritur. Për nxënësit në Kosovë, kjo periudhë, për gati një dekadë (1990-1999,) është karakterizuar me rrethana të jashtëzakonshme të zhvillimit të procesit mësimor nëpër shtëpi-shkollë, për shkak të okupimit klasik të Kosovës nga regjimi serb. Madje, përgjatë kësaj dekade edhe bashkëpunimi në shkëmbimin e plan-programeve dhe

---

<sup>1</sup> Instituti Albanologjik i Shqipërisë, *Gjuha Jonë 1-4*, Tiranë, 1993, f. 106.

<sup>2</sup> Fadil Raka: *Studime Rreth Shqipes Standarde*, Prishtinë, 2007, f. 25.

teksteve mësimore me Shqipërinë ka qenë në nivel fillestar dhe me pak rezultate. Mirëpo, në fillet e periudhës së pasçlirimit të Kosovës (1999), pra në vitet e para të shekullit të ri (shek.XXI), janë krijuar kushte të reja historike, të cilat ndikuan pozitivisht dhe ndihmuan në realizimin e nismave të përbashkëta për integrimin arsimor e kulturor të të gjithë shqiptarëve. Ndihmesa e Tiranës në përpilimin e teksteve, jo vetëm të gjuhës, por edhe për lëndët e tjera, vlerësohet të jetë shumëfish e dobishme, veçanërisht sa i përket zbatimit të plotë të normës së gjuhës shqipe. Sipas studiuesit dhe profesorit Fadil Raka: *Tekstet e lëndëve mësimore bashkë me ligjërimin e mësimdhënësve të lëndëve të ndryshme do të jenë shtylla të rëndësishme për përvetësimin më të shpejtë të normës së gjuhës standarde në shkollë.*<sup>1</sup>

Me kalimin e viteve harta e shtrirjes dhe përdorimit të gjuhës standarde në tekstet shkollore është zgjeruar duke njohur edhe rritjen dhe përmirësimin cilësor në përdorimin e normës standarde në këto tekste. Në këtë kontekst, profesori Mehmet Çeliku konstaton se: *Gjuha Standarde është shtrirë tashmë me sukses në të gjithë dokumentacionin shkollos; përmirësim shkallë-shkallë pësuat planet, programet mësimore dhe tekstet. Niveli teorik i teksteve të gjuhës është ngritur mjaft, sepse për hartimin e tyre punuan, krahas mësuesve me traditë edhe gjuhëtarë me emër, sepse në to është futur përvoja pozitive bashkëkohore e mësimdhënies, dhe sepse, në to gjetën pasqyrim arritjet shkencore të fundit për normimin e nënsistemeve të gjuhës.*<sup>2</sup>

Pavarësisht kësaj të arriture, studimet e përvojave të ndryshme kanë dëshmuar se procesi i përvetësimit të normës standarde gjuhësore në shkollë nuk është një proces i lehtë. Për më shumë, në përvetësimin e lëndës së gjuhës shqipe në shkollë detyrat janë më të rënda në krahasim me disiplinat e tjera; këtu është detyra e dyfishtë, nga njëra anë, kërkohet të pajisen nxënësit me njohuri teorike bazë të gjuhës, si shkencë, nga ana tjetër synohet zbatimi dhe ngulitja me përpikëri e normës së gjuhës standarde.

Tekstet e reja të gjuhës shqipe për shkollat nëntë-vjeçare të Kosovës, të cilat aktualisht janë në përdorim, janë përpiluar nën drejtimin e Bahri Becit. Nëse iu bëhet një vështrim i përgjithshëm këtyre teksteve rezulton se këto tekste respektojnë normën standarde gjuhësore nga të gjitha nivelet si nga ajo fonetike, morfologjike, sintaksore e deri te ajo semantike.

Të njëjtin mendim e ndan edhe profesor Çeliku kur shprehet: *Këto tekste përbëjnë një seri të tërë dhe kanë një koncept të ri. Ndër anët më pozitive të tyre, po përmendim gërshtimin ndër-lëndor, lidhjen e gjuhës me leximin letrar, karakterin praktik të theksuar dhe dhënien e njohurive gramatikore nëpërmjet tekstit, mësimin e gjuhës në funksion, në kontekst dhe në situata të caktuara. Në këto tekste i jepet rëndësi, si gjuhës së shkruar, edhe gjuhës së folur, si gjuhës, ashtu dhe ligjërimin, shkolla me dokumentacionin e ri që zotëron tani i ka të gjitha mundësitë për një zotërim praktik dhe aktiv të gjuhës standarde*<sup>3</sup>.

---

<sup>3</sup> Po aty, f. 26.

<sup>4</sup> Mehmet Çeliku: kumtesë e mbajtur në Seminarin XIX për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2001, f. 345.

<sup>5</sup> Mehmet Çeliku: *Çështje të Shqipes Standarde*, shblu, Tiranë, 2001, f. 243.

Duke vështruar, analizuar e krahasuar këto tekste është lehtësisht e vërejtshme se për dallim prej atyre teksteve të mëhershme, që kanë qenë në përdorim shkollor vite më parë, janë më të përshtatshme më të përdorshme dhe më të standardizuara, sepse tregojnë nivelin e sotëm të gjuhës letrare shqipe, arritjen e normëzimit, por edhe në studimin e kodifikimit të saj, si në drejtshkrim, morfologji, sintaksë, fonetikë, leksik e pikësim dhe në fusha të tjera. Gjithashtu, ato pasqyrojnë edhe arritjen më të fundit në metodiken e mësimdhënies çka shënon një përparim të dukshëm në cilësinë përmbajtjesore të këtyre teksteve.

Në tashmë e kemi të njohur faktin se standardi gjuhësor në librat shkollorë, fillon qysh në *Abetaren* e nxënësve, mirëpo duke u munduar të shikojmë standardin dhe duke e parë produktivitetin e këtyre librave, në vazhdimësi jemi munduar të shikojmë se sa janë produktive këto libra, mirëpo, në raste të caktuara, kemi hasur dhe në gjëra, që janë jo shumë produktive për fëmijët. Kjo ka shpërfaqur një numër problemesh dhe situatash që e rëndojnë dhe e vështirësojnë procesin e nxënies dhe përvetësimit të standardit gjuhësor.

Problemet e tilla, të identifikuara deri më tani, janë të natyrave të ndryshme si: stërngarkimi i planit dhe programit mësimor, mësimi jo i radhitur që e bën më të vështirë nxënien e standardit gjuhësor. Po ashtu, probleme të natyrës së veçantë mbesin dhe recensentët joprofesionistë, pastaj mbingarkimi teorik i teksteve si dhe konceptet e gabuara teorike të shpjegimit të dukurive gjuhësore.

Të gjitha këto probleme, të lartpërmendura, vlerësohen se e rrisin *injoinimin e gjuhës standarde nga ana e nxënësit të zakonshëm kosovar*. Për shumicën e nxënësve gjuha standarde shqipe përjetohet si diçka e detyrueshme, ngjashëm me lëndët më të vështira të plan-programit të tyre, pa e pasur ndjenjën e dëshirës dhe të vullnetit për ta folur dhe shkruar drejt gjuhën amtare. Ky përjetim vjen më shumë si rezultat i faktorëve problematikë, që u përmendën më lart, por edhe për shkak të shpërputhjes dhe dallueshmërisë së modelit të të folurit në shtëpi dhe në shkollë. Në terminologjinë e studimeve sociolinguistike kjo gjë njihet edhe si diskontinuitet kulturor i modeleve gjuhësore në shtëpi dhe shkollë (*Cultural Discontinuity of Language Patterns in the Home and School*) që në një mënyrë ose tjetrën ndikon te nxënësi në sfidimin me vështirësitë që sjell ky proces i nxënies së standardit gjuhësor në shkollë. Meqë tekstet shkollore paraqesin mediumin themelor dhe kryesor të mësimit të gjuhës standarde në Kosovë, ato domosdo duhet ta tërheqin nxënësin drejt mësimit të saj dhe jo të shkaktojnë ndjenjën e inferioritetit në raport me standardin dhe frikën për gabimet e mundshme në drejtshkrim dhe drejtshkrim. Kjo gjë mund të arrihet nëse evitohen rrethanat dhe faktorët problematikë dhe mundësohet që, jo vetëm natyra e përmbajtjes së teksteve mësimore, por edhe vetë procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të jetë atraktiv, i pranueshëm dhe gjithsesi i lakmueshëm për shkollarët e nivelit fillor dhe të mesëm, në mënyrë që t'i çlirojë ata nga ndjenja e frikës dhe e hezitimit për përballjen me gjuhën standarde.

## Raste dhe shembuj problematikë në librat shkollorë

Gjatë hulumtimeve, analizave dhe krahasimeve të teksteve shkollore për nevojat e këtij punimi kemi identifikuar disa raste dhe shembuj që paraqiten si problematikë për procesin e nxënies së standardit. Një prej këtyre rasteve është, ta zëmë, sistemi emëror në klasën e dytë shkollës fillore, ku mësohet lakimi i emrave të gjinisë mashkullore dhe femërore, në njëjës dhe në shumës, por jo edhe ai i gjinisë asnjënjëse. Për emrat e gjinisë femërore thuhet se janë ata emra të cilët mbarojnë me *a*, dhe në rrjedhën logjike të këtij formulimi natyrshëm shtrohet pyetja a thua për këta fëmijë ku na bëka pjesë emri *lulja*, i cili, ndoshta edhe mund të jetë, emri më i përmendur nga ta në komunikimin e përditshëm?! Pra, këtu lakimi i emrave nuk jepet dhe nuk mësohet në tërësi dhe pa informacione dhe sqarime të plota e të duhura. Ose, ta marrim një rast tjetër, kur në sistemin foljor në klasën e tretë mësohen koha e tashme, e shkuara dhe e ardhmja, si kohë të foljes. Në përmbajtje të këtij teksti jepet dhe e pakryera dhe e kryera, por këtu askund nuk u tregohet fëmijëve se e pakryera dhe e kryera i takojnë kohës së shkuar. Një lëshim i tillë, qoftë ai edhe informativ, mësimin e kohëve të sistemit foljor e bën të paqartë, të pakuptueshëm dhe më të vështirë për shkollarët, sepse ata nuk e kanë të qartë se a ekzistojnë vetëm tri kohë të foljes, dhe se e kryera dhe e pakryera i takojnë kohës së shkuar, apo po qëlluaka të jenë pesë kohë të foljes? Tutje, vargu i rasteve, kur brenda njëjësive të caktuara mësimore ka pasaktësi dhe mungesë të dhënash adekuate për sistemin dhe rregullat e gjuhës standarde shqipe është i gjatë. Kështu, në klasën e katërt mësohet vetëm koha e kryer e thjeshtë, pa u ndalur fare te kohët e tjera të foljes, dhe një gjë e tillë na sjell para një dileme që na bën të mendojmë seriozisht nëse fëmijët pas tre muajve të gjatë pushimi veror janë në gjendje t'i kujtojnë kohët e tjera të foljes që i kanë mësuar në klasën paraprake (të tretë), apo për ta del dhe një kohë e re, e panjohur dhe e pa mësuar më parë? Në të tilla raste, në mungesë sqarimesh dhe mësimesh të plota e të duhura, procesi i nxënies dhe përvetësimit të rregullave të normës standarde të gjuhës shqipe kalon nëpër një proces të vështirë dhe të komplikuar për shkollarët e që në fakt do të duhej të ishte e kundërta, një proces që mundëson një mësimnxënie dhe përvetësim më të kollajtë.

Një gjë e tillë është vënë re edhe nga Mimoza Gjonkutaj, e cila konstaton se: *"Sipas programeve që filluan të zbatohen më pas në klasat e ulëta është synuar që gjuha të mësohet në mënyrë praktike, ndërsa në klasat e larta u përfshinë sistemi fonetik e gramatikor i gjuhës dhe disa njohuri kryesore nga sistemi leksikor. Elementet e këtij sistemi do të jepen edhe në klasa më të ulëta, sidomos në klasën e katërt, duke ngushtuar hendekun, që ndan këto klasa. Bëhet fjalë këtu për probleme të komunikimit, të cilat kanë filluar të trajtohen përmes rubrikës 'Të flasim- të shkruajmë'"*<sup>6</sup>, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aftësimin e nxënësve, për të përdorur normën e gjuhës standarde në rrethana të caktuara të komunikimit në të folur dhe në të shkruar. Pra, në këtë mënyrë pranohet ekzistenca e problemeve të komunikimit si dhe një hendek që duhet ngushtuar ndërmjet klasave të ulëta dhe atyre të larta.

---

<sup>6</sup> Mimoza Gjonkutaj: *Didaktika e Gjuhës Shqipe*, shblu, Tiranë, 2009, f. 248.

Gjatë periudhës së zhvillimit të procesit për nxënien e gjuhës standarde është folur dhe shkruar edhe për rolin e mësuesit në këtë proces dhe aftësinë e tij/saj për ta lehtësuar procesin e nxënies dhe përvetësimit të gjuhës standarde shqipe në shkolla. Pavarësisht kësaj, *me gjithë rolin e madh të fjalës së gjallë të mësuesit, roli i tekstit është i pazëvendësueshëm, sepse edhe ai njohuritë i jep dhe i kërkon nga teksti, edhe nxënësit atë mësojnë, lexojnë e përpiqen ta riprodhojnë.*<sup>1</sup>

Nga ky konstatim rezulton se epiqendra e rëndësisë së të mësuarit të gjuhës standarde mbeten tekstet shkollore dhe çdo lëshim, gabim apo problem që identifikohet në përmbajtjet e tyre është një pengesë shtesë në rrugën e gjatë të të nxëniet të gjuhës standarde nga shkollarët fillorë dhe ata të mesëm.

Probleme me tekstet mësimore të gjuhës nuk na paraqiten vetëm në klasat e para të fillores (1-4), por edhe në ato më të larta. Kështu, në rast se e marrim dhe e analizojmë me kujdes librin e klasës V, vërejmë se këtu fillojnë të mësohen dukuritë sintaksore, e më pas dukuritë morfologjike, pra shkohet, nga sintaksa drejt morfologjisë, duke e ditur që morfologjia konsiderohet një shtyllë kryesore për mësimin e sintaksës, për mendimin tonë përmbajtja e këtij teksti mësimor do të duhej të kishte renditje tjetër të procesit të mësimin nga morfologjia drejt sintaksës.

Po ashtu, dukuritë sintaksore të mësuara në këtë klasë rimerren edhe në klasë të tjera. Duke u përsëritur nga një kasë në klasën tjetër: p.sh. në tekstin klasës V zhvillohen temat mësimore: “Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë”; “Llojet e fjalisë; fjali dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore”; “Fjalja pohore e mohore” etj, thuajse të gjitha këto njësi mësimore na përsëriten edhe në klasën VII, veçse në një kontekst më të zgjeruara. Në këtë mënyrë mund të konstatojmë se përsëritja e njësisve mësimore nga njëra klasë në tjetrën, nuk janë bërë me një planifikim as realizim të duhur dhe frytdhënës sepse, pavarësisht faktit që këto njësi tematike *zgjerohen e plotësohen në vitet e tjera, janë të ngjeshura dhe terminologjia e konceptet janë aq të larmishme e disi të ndërlikuara, sa që nxënësit shpeshherë mund të ndihen konfuz dhe në vend që të rrokin atë që është e domosdoshme për njohuritë e tyre, përpiqen ta mësojnë atë që ata e vlerësojnë si më të vështirë.*<sup>2</sup>

Ngjashëm si në tekstet shkollore të klasave më të ulëta, edhe në tekstet e klasave V-IX vihet re një mbingarkesë, ndërkohë që në klasat X-XII u lihet fare pak, për të mos thënë aspak, hapësirë njohurive gjuhësore. Ky boshllëk, që krijohet gjatë sistemit arsimor të mesëm krijon një dëm të pariparueshëm për studentin e ardhshëm, pavarësisht profilit të tij të studimit, dëm që do të reflektojë pasojat e veta, qoftë tërthorazi, edhe më gjatë.

Në një interpretim më të përmbledhur mund të thuhet se për hartimin e këtyre teksteve mësimore, janë parashikuar tema të njëjta për klasë të ndryshme dhe kjo gjë, sipas mendimit tonë, nuk rezulton të jetë pozitive për faktin se nuk lehtëson procesin e nxënies së standardit të nxënësi, përkundrazi e komplikon dhe e vështirëson atë.

---

<sup>7</sup> Akademia e Shkencave e RSP të Shqipërisë, *Gjuha jonë 1/1983*, f.59.

<sup>8</sup> Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë, *Studime albanologjike I*, Tiranë, 2011, f. 189.

Elementet problematike të lartshënuara dhe shumë të tjera si këto, kanë sjellë deri te qëndrimet dhe konstatimet e studiuesve dhe njohësve të gjuhësisë, të cilët, shkojnë aq larg, siç është rasti me Rrahman Paçarizin, i cili procesin e nxënies së standardit gjuhësor në shkolla e sheh të përjetohet nga fëmijët *si një gjuhë e re, e cila është më e lehtë se gjuhët e tjera për t'u mësuar*.

## **Përfundime**

Në përfundim të këtij punimi duhet thënë që kontaktet e para të fëmijëve me tekstet shkollore i shtynë ata të largohen nga varianti gjuhës, me të cilën janë mësuar prej kohësh dhe t'i qasen një standardi gjuhësor, me të cilin janë shkruar tekstet mësimore dhe, si të tilla, janë obliguese në planin dhe programin shkollor. Është fakt i pamohuar se gjuha e librave mësimorë ka rol dhe rëndësi vendimtare si për rritjen cilësore të mësimdhënësit, ashtu edhe për formimin gjuhësor të nxënësve, me qëllim që ata të përvetësojnë sa më mirë gjuhën letrare kombëtare, të bëhen të ndërgjegjshëm për vlerat dhe dobinë e saj dhe ta përdorin atë si mjet zhvillimi e përparimi në jetën e përditshme dhe të ardhmen e tyre prosperuese.

Nëpërmjet teksteve të gjuhës shqipe, nxënësit arrijnë të zhvillojnë shprehje komunikative, të cilat i realizojnë në tërësi si: aktin e komunikimit, të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit si dhe ngulisin dhe sistemojnë njohuri të caktuara për normat e gjuhës standarde shqipe.

Tekstet e lëndëve mësimore bashkë me ligjërimin e mësimdhënëse të lëndëve të ndryshme do të jenë shtylla të rëndësishme për përvetësimin më të shpejtë të normës së gjuhës standarde në shkollë. Meqë tekstet shkollore paraqesin mediumin themelor dhe kryesor të mësimin të gjuhës standarde në Kosovë, ato domosdo duhet ta tërheqin nxënësin drejt mësimin të saj dhe jo të shkaktojnë ndjenjën e inferioritetit në raport me standardin dhe frikën për gabimet e mundshme në drejtshqiptim dhe drejtshkrim. Kjo gjë mund të arrihet nëse evitohen rrethanat dhe faktorët problematikë dhe mundësohet që, jo vetëm natyra e përmbajtjes së teksteve mësimore, por edhe vetë procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të jetë atraktiv, i pranueshëm dhe gjithsesi i lakmueshëm për shkollarët e nivelit fillor dhe të mesëm, në mënyrë që t'i çlirojnë ata nga ndjenja e frikës dhe e hezitimit për përballjen me gjuhën standarde.

## Bibliografia

Instituti Albanologjik i Shqipërisë: *Gjuha Jonë 1-4*. Tiranë, 1993.  
Fadil Raka: *Studime Rreth Shqipes Standarde*, Prishtinë, 2007.  
*Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 19/1*, Prishtinë, 2001.  
Mimoza Gjonkutaj: *Didaktika e Gjuhës Shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2009.  
Akademia e Shkencave e RSP të Shqipërisë, *Gjuha jonë 1/1983*.  
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Filologjisë dhe Historisë: *Studime albanologjike I*, Tiranë 2011.  
Mehmet Çeliku: *Çështje të Shqipes Standarde*, SHBLU, Tiranë, 2001.

- 
- i Lidia DE FEDERICIS, Letteratura e storia, Laterza, Bari 1998, f. 11
  - ii Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f. 199
  - iii Claudie BERNARD, Le Passé recompose: Le roman historique français du XIXe siècle. [compte rendu]. N. Wolf · Romantisme Année 1997, Volume 27, Numéro 98, f. 155.
  - iv Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f.182
  - v Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f.183
  - vi Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f.196
  - vii Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f.337
  - viii Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f. 338
  - ix Robert ELSIE, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Tiranë-Pejë 1997, f. 340
  - x Sabri HAMITI, Letërsia moderne shqipe, UET-Press, Tiranë 2009, f.145
  - xi Ali ALIU, Shaban SINANI, Stefan CAPALIKU, Tonin COBANI, Letërsia bashkëkohore shqiptare, Alb-Ass, Tiranë 2001, f. 30